



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2018

**V E N D I M**

**Nr. 27, Datë 19/01/2018**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 123, datë 15.09.2017, e Z. A. C., ku pretendohet për diskriminim të tij për shkak të racës (egjiptiane), nga ana e Drejtorisë Rajonale Korçë të Entit Kombëtar të Banesave dhe Bashkisë Korçë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

Familja e Z. A. C. ka qenë një ndër familjet përfituese të njëjës prej skemave për strehim të Bashkisë Korçë. Me autorizim të këtij institucioni, në vitin 2007, Z. A. C. ka lidhur kontratë shitjeje me kusht me Drejtorinë Rajonale Korçë të Entit Kombëtar të Banesave (EKB Korçë), për një nga apartamentet në pronësi të saj. Z. A. C. ka mundur të paguajë kredinë, deri në vitin 2010 dhe jo më tej. Si pasojë, familja e tij dhe disa familje të tjera të komunitetit egjiptian kanë qenë në proces gjyqësor me Drejtorinë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë. Me vendim gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është vendosur prishja e kontratës së A. C. me Drejtorinë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë dhe kalimi i urdhërit të ekzekutimit për zbatim pranë Zyrës Përmbare Korçë.

Pas negociatave dhe ndërhyrjeve të kryera nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve të tjera shtetërore, në ndihmë të këtyre përfaqësuesve të komunitetit egjiptian, të cilët duhej të

lironin banesat e tyre dhe të mbeteshin të pastrehë, janë nënshkruar Akt-Marrëveshje ndërmjet familjeve egjiptiane dhe Drejtorisë Rajonale Korçë të Entit Kombëtar të Banesave, ku parashikoheshin vlera të reja këstesh mujore, më të përbalueshme për këto familje. Në Akt-Marrëveshjen nr. 263, datë 04.11.2014, të nënshkruar ndërmjet A. C. dhe Drejtuesit të institucionit të sipërpërmendur, përveç përcaktimit të vlerës së këstit të ri mujor, parashikohet edhe fakti që nga ana e Entit të pranohej kjo marrëveshje, duke i dhënë mundësi klientit të vazhdojë të shlyejë apartamentin e përfutur dhe të bëjë pezullimin e procesit të ekzekutimit në përmbarrim.

Në vijim, A. C. pretendon se ka aplikuar pranë Bashkisë Korçë, për të përfutur 10% bonus strehimi për banesat e dhëna me kredi të zbutur. Në datën 04.08.2017, ankuesi ka depozituar kërkesë pranë EKB Korçë, ku kërkon informacion lidhur me procesin në fjalë, si dhe mbi shfuqizimin e vendimit të gjykatës, në bazë të së cilit është lëshuar urdhëri i ekzekutimit për largimin nga banesa. Kërkesa me shkrim u paraqit në muajin gusht 2017. Ndërkohë që paraprakisht ankuesi pretendon se, në muajin korrik 2017, është paraqitur pranë zyrave të Drejtorisë Rajonale Korçë të Entit Kombëtar të Banesave, për të siguruar informacion, nëse do të lidhet ndonjë kontratë e re më këtë institucion, pasi kontrata paraardhëse është prishur me vendim gjykate.

Në ankesën e tij, A. C. shpreh shqetësimin e tij, se është duke paguar ende këstet e apartamentit të tij, por në mungesë të një kontrate, e cila të ketë zëvendësuar të mëparshmen që është shfuqizuar me vendim gjykate. Njëkohësisht, ai shprehet se nuk e ka përfutur bonusin 10% mbi kredinë e tij dhe pretendon të jetë i diskriminuar për shkak të racës nga EKB Korçë dhe nga Bashkia Korçë, ku kjo e fundit nuk e ka përfshirë në Vendimin e Këshillit Bashkiak për përfitim të këtij bonusi 10% ulje të shumës së kredisë, me justifikimin se qëndron në fuqi vendimi i gjykatës për prishje të kontratës dhe për ekzekutim nga përmbarrimi.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë :

- ☐ Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 123, datë 15.09.2017, e Z. A. C., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- ☐ Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>1</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Korçë dhe Drejtorisë

---

<sup>1</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe ngaçdo person ose burim tjetër”.

Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë, me shkresën nr. 889/1, datë 21.09.2017, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjen e parashtruar nga ankuesi.

- Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur, Drejtoria Rajonale Korçë e Entit Kombëtar të Banesave dërgoi shkresën nr. 153/1, datë 05.10.2017, ku jepen sqarimet përkatëse lidhur me pretendimet e A. C.

Sipas shkresës në fjalë, Komisioneri bëhet me dije në lidhje me faktin se në zbatim të dispozitave përkatëse ligjore dhe të politikave të strehimit për kategoritë e të pastrehëve, në vitin 2007, Drejtoria Rajonale Korçë e Entit Kombëtar të Banesave ka lidhur kontrata shitblerjeje me kusht, për disa apartamente në pronësi të saj me disa qytetarë, ndër të cilët edhe me ankuesin A. C.. Duke qenë se nga ana e familjes Celanji nuk janë përmbushur detyrimet kontraktore, që konsistojnë në pagimin në mënyrë të rregullt dhe periodik të kësteve mujore të përcaktuara në kontratë, (sikurse edhe disa familje të tjera) kjo familje është paditur në gjykatë nga Drejtoria Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë. Me vendimin gjyqësor nr. 41-2010-3783 (2342), datë 11.10.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është vendosur zgjidhja e kontratës së A. C. me Drejtorinë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë, si dhe lirimi dhe dorëzimi i apartamentit nga familja Celanji. Gjithashtu është nxjerrë edhe Urdhëri i Ekzekutimit nr. 614, datë 18.09.2014, për zbatim pranë Zyrës Përmbartimore Korçë. Në shkresë theksohet fakti se edhe pas nxjerrjes së urdhërit të ekzekutimit, Drejtoria Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë ka patur dhe ka ofruar të gjithë predispozicionin e saj, për ta ndihmuar Z. A. C. dhe familjen e tij. Ankuesit i është ofruar për nënshkrim një Aktmarrëveshje, e cila parashikonte një ristrukturim të vlerës së këstit mujor që ai duhet të shlyente. Aktmarrëveshja nr. 263, datë 04.11.2014, është nënshkruar nga të dy palët dhe klienti ka premtuar shlyerje të rregullt të kredisë nga momenti i nënshkrimit e në vijim. Ndër të tjera, Drejtoria Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë sqaron faktin se kjo Aktmarrëveshje, nuk është aneks i kontratës së zgjidhur me vendim gjykate. Ndërkohë, nëpërmjet shkresës nr. 263/1, datë 06.1.2014, ky institucion i ka kërkuar Zyrës Përmbartimore Korçë pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor për një afat të pacaktuar.

Në vijim, duke konstatuar se A. C. nuk ka qënë i rregullt me pagesat e kredisë, me shkresën nr. 198, datë 15.10.2015, të EKB Korçë, ai është njoftuar se nuk e ka respektuar Aktmarrëveshjen e nënshkruar 1 vit më parë, duke i lënë një afat disa ditë për shlyerjen e detyrimit të papaguar. Sërisht, nëpërmjet shkresës nr. 217, datë 05.12.2016, EKB Korçë e ka njoftuar A. C., se rastin e tij e konsideron pa vullnet për shlyerjen e detyrimit dhe është e detyruar të kërkojë ekzekutimin e vendimit gjyqësor për lirimin e dorëzimit të banesës.

Për sa më sipër, Z. A. C. ka dorëzuar në datën 27.12.2016 pranë EKB Korçë, deklaratën noteriale nr. 9324 rep., datë 27.12.2016, ku deklaron se do të shlyejë me korrektësi, këstet mujore dhe në rast të kundërt EKB Korçë mund të kryejë ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

Në shkresën nr.153/1, datë 05.10.2017, të EKB Korçë theksohet fakti se edhe pas kësaj deklarate, A. C. nuk rezulton të ketë shlyer rregullisht këstet e kredisë. Në këto kushte, Enti Kombëtar i Banesave nuk mund t'i ofrojë më ndihmë familjes së Z. A.C., e cila ligjërisht është e detyruar të lirojë banesën.

- Në përgjigje të shkresës nr. 889/1, datë 21.09.2017 dhe shkresës nr. 889/3, datë 27.10.2017 të Komisionerit, Bashkia Korçë dërgoi shkresën nr. 1074/2, datë 03.11.2017, ku e bën me dije Komisionerin se A. C. nuk ka depozituar asnjë kërkesë me shkrim për përfitim granti të menjëherëshëm 10% pranë këtij institucioni. Ndërkohë që në këtë shkresë theksohet fakti se EKB Korçë i ka kërkuar Bashkisë së këtij qyteti që për personat me problem në vlefshmërinë e kontratave, duhet të kryhen verifikimet përkatëse paraprakisht nga vetë ky institucion.

☐ Në vijim të procedurave të shqyrtimit të ankesës nr. 123, datë 15.09.2017, të Z. A. C., në zbatim të Urdhërave nr. 154 dhe 155, datë 02.11.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në datën 08.11.2017, u kryen inspektime pranë Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave dhe pranë Bashkisë Korçë.

- Gjatë inspektimit të kryer pranë Drejtorisë së Kujdesit Social, të Bashkisë Korçë, inspektorët e Komisionerit u informuan mbi çështjet që përbënin objekt të urdhërit të inspektimit. Nga verifikimet e kryera rezultoi se A. C. nuk kishte depozituar kërkesë me shkrim pranë këtij institucioni, për përfitim granti të menjëherëshëm 10%, por ishte paraqitur disa herë pranë Drejtorisë së Kujdesit Social, të Bashkisë Korçë dhe kishte kontaktuar me personat përgjegjës, të cilët e kanë sqaruar me hollësi që duhet të depozitonte kërkesë me shkrim, si dhe një kopje të kontratës së lidhur me EKB Korçë. Pavarësisht sqarimeve të tyre, deri më sot, ankuesi nuk ka depozituar asnjëherë as kërkesë me shkrim dhe as nuk ka dorëzuar kontratën e lidhur me EKB Korçë, pranë këtij institucioni.

Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Kujdesit Social, rezulton se edhe nëse A. C. do të kishte paraqitur kërkesë me shkrim, sërisht nuk mund ta përfitonte grantin e menjëherëshëm, pasi kontrata e shitjes me kusht, që ky qytetar ka patur me EKB Korçë është zgjidhur me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Bashkëlidhur kërkesës për përfitim granti, në çdo rast duhet dorëzuar edhe kontrata e shitjes me kusht, e lidhur me Drejtorinë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë. Inspektorët e Komisionerit i njohën personat përgjegjës pranë Bashkisë Korçë, më Aktmarrëveshjen e lidhur ndërmjet EKB Korçë dhe A. C., në vijim të kontratës së zgjidhur me vendim gjyqësor dhe i pyetën se, nëse A. C. do të kishte depozituar këtë Aktmarrëveshje në vend të kontratës, bashkëlidhur kërkesës me shkrim a do të mund të merrej në konsideratë për përfitim granti. Personat përgjegjës pranë këtij institucioni sqaruan se A. C. nuk mund ta përfitonte në asnjë rast grantin e menjëherëshëm, pasi Aktmarrëveshja ndërmjet palëve, është lidhur mbi bazën e një kontrate të zgjidhur me vendim gjykate.

- Gjatë inspektimit të kryer pranë Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë, inspektorët e Komisionerit u bënë me dije lidhur me fakti se ankuesi nuk kishte paguar 99 këste të kredisë së tij. Që prej vitit 2014, si vlerë kësti mujor konsiderohej vlera e përcaktuar në Aktmarrëveshjen e lidhur në vitin 2014. Drejtori i këtij institucioni sqaroi se Aktmarrëveshja ndërmjet EKB Korçë dhe qytetarit, është lidhur në kushtet, kur ai nuk mund të paguante vlerën e këstit mujor dhe pas zgjidhjes së kontratës së shitjes me kusht me vendim gjyqësor, ankuesi duhet të lironte dhe dorëzonte banesën e tij. I pyetur për vlefshmërinë ligjore të Aktmarrëveshjes, Z. I. K., drejtori i Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë theksoi faktin se Aktmarrëveshja në fjalë është hartuar duke iu referuar Udhëzimit nr. 2935, datë 22.10.2014, të Drejtores së Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave dhe kopje të këtyre aktmarrëveshjeve të nënshkruara janë depozituar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave, Tiranë. Ndër të tjera, duke iu referuar objektit të urdhërit të inspektimit, Z. I. K. sqaroi se në situatën e familjes së Z. A. C. ndodhen edhe 3 familje të tjera, ndër të cilat vetëm njëra prej tyre i përket komunitetit egjiptian.Dy prej këtyre familjeve kanë paguar rregullisht këstet e përcaktuara në Aktmarrëveshjet përkatëse.

☐ Në vijim të inspektimeve të kryera, nëpërmjet shkresës nr. 1142, datë 22.11.2017, Komisioneri iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave në Tiranë, ku pasi i bën një parashtrim të situatës konkrete, si dhe kërkon opinionin e këtij institucioni mbi vlefshmërinë ligjore të Aktmarrëveshjes së lidhur ndërmjet Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë dhe qytetarit A. C..

- Në përgjigje të shkresës nr. 1142, datë 22.11.2017, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave dërgoi shkresën nr. 2392/1, datë 04.12.2017.

Në shkresën e sipërpërmendur, Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave sqaron se pasi është njohur në tërësi me të gjithë praktikën dhe procedurën e ndjekur nga EKB Korçë për rastin e këtij qytetari, gjykon se kjo strukturë, jo vetëm që nuk ka patur si qëllim diskriminimin e A. C., por përkundrazi ka kapërcyer dhe nuk ka zbatuar procedurat ligjore të parashikuara, vetëm për të mos shkaktuar problem sociale për këtë familje dhe në përgjithësi për të gjitha familjet që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian. Për raste të ngjashme, Drejtoritë Rajonale të EKB-së kanë vepruar për të zbatuar vendimet e gjykatës, të kthyera në tituj ekzekutivë.

Në shkresë theksohet fakti se mbështetur në informacionin e marrë nga EKB Korçë, A. C. edhe pse ka lidhur një Aktmarrëveshje me këtë institucion, për të vazhduar shlyerjen e detyrimeve, sërisht nuk e ka respektuar dhe zbatuar. Në shkresë theksohet se pavarësisht dëshirës dhe qëllimit pozitiv të palëve, rezulton që Aktmarrëveshja të jetë një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm.

Në përfundim, Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave thekson faktin se është e detyruar të procedojë në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe i ka konsumuar të gjitha mundësitë ligjore për t'i ofruar mundësi shlyrje dhe përfitim në kohë këtij qytetari, që në këtë rast kanë cuar edhe në tejkalim të kompetencave dhe në nxjerrjen e një akti administrativisht të paligjshëm nga dega rajonale përkatëse.

Në shqyrtimin e ankesës nr. 123, datë 15.09.2017, e Z. A. C. , Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që atij i atribuon ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

**Mbështetur në provat e administruara nga të dy palët, Komisioneri gjykon se:**

**I. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe disfavorizues të pretenduar nga ankuesi:**

Në zbatim të dispozitave përkatëse ligjore dhe të politikave të strehimit për kategoritë e të pastrehëve, në vitin 2007, Drejtoria Rajonale Korçë e Entit Kombëtar të Banesave ka lidhur kontrata shitblerjeje me kusht, për disa apartamente në pronësi të saj me disa qytetarë që i përkasin komunitetit egjiptian, por edhe të maxhorancës, ndër të cilët edhe me ankuesin A. C.. Duke qenë se nga ana e familjes së Z. A. C. nuk janë përmbushur detyrimet kontraktore, që konsistojnë në pagimin në mënyrë të rregullt dhe periodik të kësteve mujore të përcaktuara në kontratë, (sikurse edhe disa familje të tjera) kjo familje është paditur në gjykatë nga Drejtoria Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë. Me vendimin gjyqësor nr. 41-2010-3783 (2342), datë 11.10.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është vendosur zgjidhja e kontratës së A. C. me Drejtorinë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë, si dhe lirimi dhe dorëzimi i apartamentit nga familja e Z. A. C. Gjithashtu, është nxjerrë edhe Urdhëri i Ekzekutimit nr. 614, datë 18.09.2014, për zbatim pranë Zyrës Përmbartimore Korçë.

Pavarësisht sa më sipër, A. C. nuk është detyruar të lirojë e dorëzojë banesën e tij dhe të jetë kontigjent i të pastrehëve, pasi Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave Korçë, për të evituar një gjë të tillë, nëpërmjet shkresës nr. 263/1, datë 06.01.2014, i ka kërkuar Zyrës Përmbartimore Korçë pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor për një afat të pacaktuar. Në vijim, ndërmjet ankuesit dhe Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave është lidhur Aktmarrëveshja nr. 263, datë 04.11.2014, ku rristrukturohej vlera e kështit mujor, që klienti duhet të paguante për të shlyer kredinë e marrë.

Nëse do t'i referohemi tekstit të kësaj Aktmarrëveshjeje, konstatohet se ndër të tjera, në të është parashikuar: “.....Z. A. dhe Znj. A. C. është klient i EKB Korçë pasi ka përfituar një apartament me autorizim të Bashkisë Korçë dhe ka lidhur kontratë me EKB Korçë, sipas udhëzimit 19 me vlerë të kredisë 3 131 100 lek..... Në datën e sotme të dyja palët bien dakord që të bëhet rristrukturimi i shlyerjes së kredisë duke përlllogaritur kështin e ri deri në afatin e përcaktuar për mbylljen e kontratës”. Në këtë kontekst rezulton se Aktmarrëveshja në fjalë e konsideron kontratën e shitjes me kusht të lidhur ndërmjet palëve, si një kontratë ende në fuqi, pasi nuk



përmendet fakti që kontrata në fjalë është e zgjidhur me vendimin gjyqësor nr. 41-2010-3783 (2342), datë 11.10.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Rrjedhimisht Aktmarrëveshja përbën një akt administrativ, i cili thjesht ristrukturon vlerën e kështit mujor, të përcaktuar në kontratë, duke marrë si të mirëqëna të gjitha përcaktimet e tjera të kontratës. Kjo Aktmarrëveshje në vetëvete, është një akt i nxjerrë në zbatim të një kontrate të zgjidhur gjyqësisht ndërmjet palëve. Nëpërmjet shkresës nr. 2392/1, datë 04.12.2017, drejtuar Komisionerit, Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave<sup>2</sup> e ka cilësuar Aktmarrëveshjen nr. 263, datë 04.11.2014, të lidhur ndërmjet EKB Korçë dhe Z. A. C., si një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm.

A. C. ka vazhduar të paguajë kështet mujore (të ristrukturuara) të kredisë (edhe pse jo në mënyrë të rregullt e jo periodike), sipas Aktmarrëveshjes në fjalë, që prej datës 04.11.2014, ndërkohë që një Aktmarrëveshje e tillë është absolutisht e pavlefshme. Referuar pikës 1 të nenit 110, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”<sup>3</sup>, një akt i tillë nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ky akt konsiderohet se nuk ekziston. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se edhe nëse A. C. do të kishte kryer me korrektësi pagesat e kësteve mujore (sipas Aktmarrëveshjes në fjalë) dhe ta kishte shlyer kredinë e tij, në kushtet, kur ai nuk ishte më i lidhur kontraktualisht me EKB Korçë, në asnjë rast nuk do të ishte bërë pronar i banesës së tij.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se A. C. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e EKB Korçë, pavarësisht se qëllimi i këtij institucioni nuk ka qenë i tillë. Në rastin konkret, Komisioneri vlerëson se EKB Korçë duhet të kishte lidhur një kontratë të re me ankuesin, ku të ristrukturohej vlera e kështit të kredisë, në kushtet kur kontrata e mëparshme është zgjidhur me vendim gjykate, ose të lidhte me ankuesin një Aktmarrëveshje të tillë, ndërkohë që kontrata e shitjes me kusht me A. C. ishte ende në fuqi.

-Ankesa e A. C. drejtohet edhe ndaj Bashkisë Korçë, për shkak të mospërfitimit të grantit të menjëhershëm 10%, duke pretenduar se ky institucion e ka diskriminuar për shkak të racës egjiptiane. Në këtë kontekst, duke marrë në vlerësim provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit administrativ, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një qendrimit të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Korçë, për dy arsytet e mëposhtëme:

---

<sup>2</sup> Në piken 2, të nenit 110, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet: “Pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, të çdo të interesuari, nga organi publik që e ka nxjerrë atë, organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative, si dhe nga gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit”.

<sup>3</sup> Pika 1 e nenit 110 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikon: “1. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston”.

**Së pari**, ankuesi nuk ka depozituar kërkesë me shkrim<sup>4</sup> pranë këtij institucioni, për t'u marrë në konsideratë dhe për t'u shqyrtuar si kandidaturë e mundshme për të përfituar këtë bonus dhe,

**Së dyti**, ai nuk legjitimohet për përfitimin e këtij bonusi, në kushtet kur kontrata e tij me EKB Korçë është zgjidhur gjyqësisht.

Në këto kushte, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioneri gjykon se familja e Z. A.C. nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e Bashkisë Korçë dhe nga ana e Drejtorisë Rajonale Korçë të Entit Kombëtar të Banesave.

## **II. Shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi.**

Ankuesja pretendon se diskriminohet për shkak të racës (egjiptiane) nga ana e Bashkisë Korçë dhe nga ana e Drejtorisë Rajonale Korçë të Entit Kombëtar të Banesave.

“Raca” është njëri nga shkaqet, për të cilat Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, **racën**, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

- Nga analizimi në tërësi i fakteve dhe provave të administruara përgjatë procesit të hetimit administrativ, rezulton se lidhur me pretendimin e A. C. për diskriminim për shkak të “racës”, nga ana e Bashkisë Korçë, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Korçë, për shkak se i përket komunitetit egjiptian. Ankuesi nuk ka zbatuar dispozitat përkatëse, ligjore dhe nuk ka depozituar minimalisht një kërkesë me shkrim për përfitim granti të menjëherëshëm pranë Bashkisë Korçë.
- Lidhur me pretendimin e A. C. për diskriminim për shkak të racës, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë, Komisioneri vë në dukje se pavarësisht faktit se Aktmarrëveshja nr. 263, datë 04.11.2014, e lidhur ndërmjet ankuesit dhe EKB Korçë është konstatuar nga organi epror i këtij institucioni, si një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, të tilla Aktmarrëveshje janë lidhur edhe me dy familje te tjera që nuk i përkasin komunitetit egjiptian. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se trajtimi i padrejtë dhe

---

<sup>4</sup> Referuar nenit 41, pika 3, gërma b) të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.



disfavorizues i EKB Korçë, ndaj A. C. nuk lidhet me përkatësinë e tij në komunitetin egjiptian.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se ndodhemi në kushtet e mosdiskriminimit për shkak të racës së ankuesit, nga ana e Bashkisë Korçë dhe Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë.

### **III. Lidhur me justifikimin e subjekteve, ndaj të cilëve drejtohet ankesa, Komisioneri gjykon se:**

Nëpërmjet korrespondencës zyrtare me Drejtorinë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë, ky institucion ka theksuar faktin se qëllimi i tij i vetëm ka qenë ka qenë ndihma për t'i siguruar ankuesit mundësinë për të shlyer kredinë dhe për të patur banesën e tij, duke shmangur detyrimin e tij për të liruar dhe dorëzuar banesën që prej vitit 2104, pas zgjidhjes gjyqësisht të kontratës së shitjes me kusht dhe daljes së urdhërit të ekzekutimit.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur nenet 1, 2, 3, pika 1, neni 4, pika 1, neni 7, pika 1, neni 20, neni 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 e 10 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi",

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të racës (egjiptiane) të Z. A. C., nga ana e Bashkisë Korçë.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të racës (egjiptiane) të Z. A. C., nga ana e Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë
3. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Irma BARAKU**

**KOMISIONER**

(Shkaku: raca  
Fusha: te mira e sherbime)